

N J O F T I M P E R V E N D T E L I R E P U N E

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor Berat shpall kete vend te lire pune :

-Mjek i KSHP ne Drejtorine Rajonale te Sigurimit te Kujdesit Shendetesor Berat.

Kandidati duhet te plotesoje keto kushte:

- 1.Te kete mbaruar arsimin e larte Dega Mjekesi e Pergjitheshme..
- 2.Eksperienca ne pune do te jete avantazh
- 3.Nota mesatare do te jete avantazh
- 4.Zoterimi i gjuheve te huaja do te jete avantazh(deshmi,çertifikate)
- 5.Te zoteroje kompjuterin ne programet baze Word & Excel.
- 6.Te jete i komunikueshem.

Te interesuarit duhet te paraqesin prane DRSKSH Berat,brenda dates 15/02/2009

keto dokumenta:

- Kerkese me shkrim per tu punesuar
- Çertifikate personale me fotografi
- Deshmi penaliteti(dokument i leshuar nga Ministria e Drejtesise jo me pare se 3 muaj nga data e paraqitjes prane DRSKSH
- Diplomen dhe listen e notave;pershkrimin e edukimit dhe karrieres profesionale.(CV)
- Deshmi per kualifikime te ndryshme dhe gjuhen e huaj,reference ne pune nga vendi i punes/vendet e punes ku ka punuar.
- Librezen e punes (fotokopje)

Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose te noterizuara.

Dokumentat te dorezohen ne zarf te mbyllur i cili protokollohet.

Te interesuarit te paraqesin dokumentat prane DRSKSH Berat,brenda afatit te mesiperm.

MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES

FTESË PËR OFERTË

1. Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes bazuar ne VKM nr. 113, date 02.02.2009 “Per percaktimin e autoritetit kontraktues per dhenien me koncension te sherbimit te regjistrit te barreve siguruese”, dhe VKM nr. 27 date 19.01.2007 “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve i ndryshuar, shpall ftesen per pjesmarrje ne proceduren konkuruese “per dhenien me koncension te sherbimit te regjistrit te barreve siguruese”.
2. Kërkohet që projekti te realizohet ne Tirane.
3. Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentat standarde te procedures

konkurrese ne Drejtorine e Sherbimeve Juridike, prane METE, me personin pergjegjes te caktuar Zj. Mimoza KITA.

4. Një kopje e plotë e dokumentave standarde të konkurimit mund të blihet nga kandidatet e interesuar me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar Autoritetit Kontraktues në zyrën e cituar më sipër dhe me pagesën e një tarife të pakthyeshme prej 5 000 Leke, tarife e cila do të derdhet ne Nr.llog 0104030780 te METE-s, prane “Raiffeisen Bank” Tirane.
5. Ofertuesit te paraqesin vetem nje oferte, ku te angazhohen se pranojne kushtet e percaktuara ne ftesen per procedure konkurrese dhe detyrimet qe rrjedhin nga fitimi i procedures konkurrese. Shpenzimet e kryera per te marre pjese ne proceduren konkurrese nuk rimbursohen nga Autoriteti Kontraktues.
6. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumenta ligjorë dhe administrativë origjinalë ose kopje te noterizuar, si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e procedures konkurrese dhe te dërgohen tek Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, ne adresen: Bulevardi “Deshmoret e Kombit” 1001-Tirane.
7. Sigurimi i ofertes, qe eshte në shumën prej 2% te vleres se Projektit, të dorëzohet së bashku me oferten. Format e pranueshme të sigurimit janë përshkruar në dokumentat e procedures konkurrese.
8. Asnjë ofertues nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në proceduren e konkurimit në bazë të shtetësisë.
9. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data **13 Mars 2009, ora 13⁰⁰**. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.
10. Ofertat do të hapen ne Ministrine e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, ne Sallen e Mbledhjeve, Kati i pare, data 13 Mars 2009, ora 13⁰⁰.
11. Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

BASHKIA KUÇOVE

Ne zbatim te ligjit 8549 , date 11.11.1999. , “Statusi i nepunesit Civil “ , Drejtoria e Burimeve Njerezore ne Bashkine Kuçove , shpall konkurimin per nje vend te lire pune ne pozicionin :

SPECIALIST NE DREJTORINE E SHERBIMEVE DHE TRANSPORTIT NE BASHKINE KUCOVE

Kandidatet duhet te plotesojne kerkesat e pergjithme per pranimin ne sherbimin civil ne perputhje me nenin 12 te ligjit 8549 , date 11.11.1999. “ Statusi i nepunesit civil “

KERKESAT E VECANTA PER KANDIDATET JANE :

1. Te kete mbaruar arsimin e larte , Fakultetin e Inxhinierise Elektrike .